

# PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Lufta në zhvillim e sipër e Rosisë kundër Ukrainës është një nga faktorët që ka intensifikuar tensionet ekzistuese gjeopolitike përgjatë vitit 2022 dhe vitit 2023, duke ekspozuar **mangësitë e vazhdueshme të sundimit të ligjit** dhe boshllëqe të tjera të qeverisjes në Europën Juglindore (EJL-9<sup>149</sup>). Kjo, nga ana tjetër, ka nxitur përpjekjet për të rinovuar procesin e bllokuar të integritimit dhe konsolidimit në BE, i cili shërben si shtytësi kryesor i reformave të qeverisjes së mirë në rajon. Raporti aktual bazohet në masat e ndërmarra ndërkombëtarisht apo edhe nga ana e BE<sup>150</sup>, për të forcuar sundimin e ligjit dhe thekson fushat kritike të ndikimit që mund të arrihen nëpërmjet partneriteteve publike-private. Ky Raporti i dytë Mirë-Qeverisjes në vendet e Europës Juglindore, fokusohet në instrumentin e një **baze** të zgjeruar të dhënash (Big Data) për të identifikuar ekzistencën e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe që rezultojnë të fshehura nga persona të ekspozuar politikisht<sup>151</sup>. Këto mjete mund të ndihmojnë në **zvogëlimin e praktikave të kapjes së shtetit** dhe të medias në rajon, parandalimin e prirjeve autoritariste, uljen e ndikimit që vjen prej vendeve të huaja jomiqësore që kërcënojnë demokratizimin Euro-Atlantik të Europës Juglindore<sup>152</sup>.

<sup>149</sup> Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Rumania, Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia.

<sup>150</sup> Për më tepër lexo: European Commission, *2022 Rule of Law Report*, 13 July 2022. European Commission, *European Democracy Action Plan: making EU democracies stronger*, 3 December 2020; Court of Justice of the European Union, *Press Release: Measures for the protection of the Union budget*, 16 February 2022; White House, *United States Strategy on Countering Corruption*, December 2021; U.S. Department of State, *Western Balkans Sanctions*, Office of Economic Sanctions Policy and Implementation, 3 October 2022; U.S. Department of the Treasury, *Treasury Sanctions Influential Bulgarian Individuals and Their Expansive Networks for Engaging in Corruption*, 2 June 2021; U.S. Department of State, *The Summit for Democracy*, 2022; and International Anti-Corruption Conference, *The Washington Declaration: Uprooting Corruption, Defending Democratic Values*, 12 December 2022.

<sup>151</sup> Raporti i parë për qeverisjen e mirë në vendet e EJL u publikua në vitin 2022 dhe synonte të zbulonte mënyrat se si krijohet pasuria e paligjshme. Për më shumë lexo: Mineva, D. et al., *Public Procurement Integrity in Southeast Europe: Mechanisms, Red Flags, and State-Owned Enterprises in the Energy Sector*, Sofia: Center for the Study of Democracy, 2022.

<sup>152</sup> Center for the Study of Democracy, *Countering the Kremlin Playbook in Europe after Russia's Invasion of Ukraine*, Policy Brief No. 115, October 2022.

## Deklarimi i asetëve si instrument për parandalimin e korrupsionit dhe vlerësimin e rrezikut

Deklarimi i asetëve është një instrument i fortë, por aktualisht i **pashfrytëzuar për parandalimin e korrupsionit dhe financimit të paligjshëm** në radhët e nëpunësve civilë dhe në veçanti ndërmjet personave të ekspozuar politikisht në vendet e EJL-9. Media dhe shoqëria civile në rajon, së bashku me organizatat ndërkombëtare, vazhdimisht hetojnë dhe raportojnë për boshllëqet e shumta evidente midis standardeve reale të jetesës në të cilën jetojnë politikanët dhe familjet të tyre dhe asaj që ata zyrtarisht deklarojnë publikisht si pjesë e pasurisë dhe të ardhurave të tyre. Në të gjitha shtetet e EJL-9 ekziston kuadri ligjor që përfshin deklaramin e pasurisë si një nga instrumentet e përdorura në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, këto **rregullore rrallëherë zbatohen në mënyrë të qëndrueshme** dhe në vend të kësaj, më së shumti rezultojnë në skandale sporadike jetëshkurtra ose në fushata të rastësishme represioni kundër kundërshtarëve politikë. Në mënyrë që ky mjet të bëhet një instrument efektiv për të luftuar kapjen e shtetit dhe korrupsionin në EJL-9, ky raport analizon kuadrin ligjor dhe institucional të deklaratave të pasurisë dhe propozon një sërë zgjidhjesh të mundshme mbi politikën për tejkalimin e mangësive që mund të kenë këto instrumenta.

## Verifikimi dhe kontrolli i deklaratave të pasurisë

Disa persona të ekspozuar politikisht, si dhe kategori të tjera të nëpunësve civilë në EJL-9, **nuk janë të detyruar të deklarojnë pasurinë** e tyre dhe si rrjedhojë, pasuria e tyre mbetet e fshehur nga institucionet shtetërore dhe publiku i gjerë. Ky problem është më i theksuar **në lidhje me menaxherët e lartë, drejtorët dhe anëtarët e bordit të ndërmarrjeve shtetërore**. Këta individë nuk janë të detyruar të deklarojnë pasurinë e tyre në Serbi (përveç nëse emërohen nga qeveria) dhe në Bosnje dhe Hercegovinë (BiH). Gjithashtu, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme ligjore, informacioni që individët janë të detyruar të deklaro-

jnë, rrallëherë është gjithëpërfshirës, gjë që pengon parandalimin e fenomenit dhe zbatimin e duhur të ligjit. **Boshllëqet ligjore** që lejojnë shmangien e zbulimit të këtyre rasteve janë të përhapura në të gjithë rajonin. Për shembull, në Hungari jo gjithmonë është e detyrueshme deklarimi i kredive nga individët privatë ndërsa dhuratat për familiarët e afërt nuk bëhen fare publike<sup>153</sup>. Në Bullgari dhe Kroaci bashkëshortët dhe bashkëjetuesit nuk janë të detyruar ligjërisht të informojnë partnerët e tyre për pasuritë që zotërojnë, duke siguruar në këtë mënyrë një rrugë shpëtimi. Si në Hungari, ashtu edhe në Maqedoninë e Veriut, personave të ekspozuar politikisht u kërkohet të deklarojnë pronësinë e aksioneve në kompani, por jo asetet që zotërojnë nga këto kompani dhe si rrjedhojë, asetet personale deklarohen si pronë e korporatës.

Një nga format me te zakonshme të **fshehjes së pasurive nga zbulimi** është transferimi i tyre tek anëtarët e familjes ose tek të afërmit e ngushtë. Gjithashtu një tjetër formë e përdorur për tu pasuruar është dhe lehtësimi i mënyrave të “gjenerimit” të pasurisë së paligjshme duke siguruar trajtim preferencial ose duke siguruar një mënyrë tjetër avantazhi konkurrues.

Megjithatë, në shumicën e vendeve të analizuara, vetëm pasuritë në pronësi të bashkëshortëve, bashkëjetuesve dhe ndonjëherë edhe të fëmijëve, kanë detyrimin të deklarohen dhe si rrjedhim bëhen objekt kontrolli nga organet përgjegjëse. Në Rumani, fëmijët e personave të ekspozuar politikisht nuk përfshihen në deklaratat e pasurisë pas arritjes së moshës madhore, duke e bërë më të vështirë identifikimin e konfliktit të interesit ose asetëve të fshehura. Prindërit e personave të ekspozuar politikisht kontrollohen pothuajse vetëm në gjysmën e vendeve.

Shumica e shteteve të EJK-9 kanë procedura për dorëzimin në kohë të deklaratave të pasurisë dhe për kryerjen e një kontrolli bazë fillestar për mospërputhjet

<sup>153</sup> Cseke, B., “Sziijártó megépitette a műfüves foci pályát a balatoni nyaralóhoz, de alig látják mostanság a faluban” [Sziijártó ka ndërtuar një fushë futbollit me bar artificial për shtëpinë e pushimit në Liqenin Balaton, por rrallëherë qëndron në fshat], *telex.hu*, 2021.08.12.; Oroszi, B. and Gergely, M., “Saját lábon forgó palota – feltártuk a hatvanpusztai Orbán-uradalom titkait” [Pallati më vete – ne kemi zbuluar sekretet e pasurisë Orbán në Hatvanpuszta], *hvg.hu*, 2021.06.24.

midis të ardhurave dhe pasurive të deklaruara (p.sh., kontrolli fillestar “aritmetik-logjik” në Shqipëri). Megjithatë, **asnjë nga nëntë vendet e analizuara nuk ka një sistem të auditimeve gjithëpërfshirëse të stilit të jetesës** të zyrtarëve. Kjo është kryesisht për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme njerëzore, të afta për të kryer kontrole të thelluara, duke përfshirë kontrole të kryqëzuara në regjistra të shumtë në nivel kombëtar dhe jashtë vendit, ku shpesh depozitohet pasuria e paligjshme. Kjo çështje përkeqësohet nga numri i madh i personave të detyruar të paraqesin deklarata në disa nga vendet e EJK-9 (p.sh., për sa i përket vitit 2022 në Rumani janë paraqitur rreth 300 mijë deklarime<sup>154</sup>). Në mënyrë ideale, kontrole duhet të iniciohen në mënyrë anonime edhe prej palëve të treta të tilla si: sinjalizuesit, organizatat e shoqërisë civile (CSO-të), publikimet në media, etj.). Megjithatë, sipas ligjeve kombëtare, **indicjet anonime nuk pranohen** në Bullgari, Maqedoninë e Veriut dhe në Rumani. Në BiH, kontrole të tilla lejohen dhe parashikohen në ligj, por jo gjithmonë janë funksionale në praktikë. Në Hungari, kontrollohen vetëm indicje të mbështetura nga prova të forta.

Një mënyrë e zakonshme e evidentuar si shkelje, ka të bëjë me **mospërputhjen midis vlerës reale të tregut të aktiveve dhe çmimit të blerjes së tyre**, siç është regjistruar në dokumentet zyrtare të blerjes/pronësisë. Në disa raste, vilat dykatëshe janë deklaruar si “bodrume vere” në Hungari<sup>155</sup>. Në Bullgari, ai që u bë i njohur gjerësisht si skandali “Apartament-Gate” rrëzoi një sërë figurash të larta politike dhe qeveritare, të cilët kishin deklaruar blerjen e asetëve me vlera shumë të ulëta<sup>156</sup>. Kontrollimi, krahasimi dhe vërtetimi i një mospërputhjeje ndërmjet vlerës së tregut dhe asaj kontabël të aktiveve është një procedurë e ndërlikuar, për të cilën autoritetet rrallëherë posedojnë njohuritë dhe kapacitetin e nevojshëm. Kështu, gazetarët investigativë dhe shoqëria civile mbeten vendimtare për zbulimin dhe paralajmërimin kundër parregullsive të tilla.


<sup>154</sup> Agenția Națională de Integritate (A.N.I.), *Raport Anual de Activitate, 2021* [Rumania, Agjencia Kombëtare e Integritetit (ANI), Raport Vjetor i Veprimtarisë, 2021]; Në vitet elektorale, të gjithë kandidatët në Rumani kanë detyrimin të paraqesin deklarata, duke shkaktuar rritjen e mëtejshme të kësaj numër.

<sup>155</sup> Átlátszó, “Képviseői vagyonnyilatkozatok: nyomokban átláthatóságot tartalmaz!” [Deklaratat e pasurisë së zyrtarëve: përmbajnë gjurmë transparence!], 2022.01.31.; and EuroPAM, *Financial Disclosure – Hungary*, 2020.

<sup>156</sup> Dimitrov, M., “Bulgaria’s ‘ApartmentGate’ Scandal Engulfs Anti-Corruption Chief”, *Balkan Insight*, 1 April 2019.

Një çështje tjetër shqetësuese është periudha kohore që deklaratat e pasurive qëndrojnë të aksesueshme publikisht. Në Kroaci dhe Hungari, **deklaratat e pasurisë hiqen nga regjistrat publikë** një vit pas përfundimit të mandatit përkatës të personit të ekspozuar politikisht, dhe në Serbi – pas tre vjetësh. Në Maqedoninë e Veriut,

**Shembull i një liste gjithëpërfshirëse të treguesve të rrezikut për kontrollin e deklaratave të pasurisë**



**Burimi:** CSD, bazuar në: Banka Botërore, *Automated Risk Analysis of Asset and Interest Declarations of Public Officials: A Technical Guide*, 2021; Council of Europe, *Practitioner Manual on Processing and Analysing Income and Asset Declarations of Public Officials*, 2014; Poltoratskaia, V., *Use of Asset Declarations and Procurement Data to Identify Risk*, Presentation at the workshop “Developing Risk Indicators for Assets Declaration and Public Procurement Data”, Government Transparency Institute / Central European University, Armenia, Yerevan, 15-16 June 2022; OECD, *Verifying Asset Declarations in Greece: Guidelines for Standard Procedures and Oversight Bodies*, 2017.

deklaratat e pasurisë hiqen menjëherë pasi një person i ekspozuar politikisht largohet nga zyra<sup>157</sup>. Kjo kufizon më tej kujtesën publike dhe mund të pengojë punën investigative të medias dhe shoqërisë civile.

Kryerja e kontrolleve të kryqëzuara në regjistra të shumtë publikë dhe shkëmbimi i informacionit me institucione të tjera publike si në nivel kombëtar ashtu edhe

jashtë vendit, është **jetik për rritjen e efekteve të dobishme dhe parandaluese të deklaratave të pasurisë**. Këta mekanizma ekzistojnë në faza të ndryshme të zhvillimit në të gjithë EJT-9. Megjithatë, pavarësisht përpjekjeve të shumta për të ndërlidhur regjistrat publikë kombëtarë nëpër vendet e analizuara, **kontrollat e kryqëzuara ad hoc vazhdojnë të kryhen manualisht** në shumicën e rasteve. Në Kroaci, Komisioni i Konfliktit të Interesit (CIC)

### Boshllëqe të vjetra në procedurat e verifikimit dhe kontrollit të deklaratave të pasurisë

Kontrolli verifikon vetëm informacionin e raportuar, por jo nëse ka ndonjë pasuri të padeklaruar

Shtirje e kufizuar e asetëve që duhet të deklarohen (p.sh. PEP-të duhet të zbulojnë shumicën e aksioneve të tyre në kompani, por jo asetet që zotërojnë në ato kompani)

Nuk ka specifikime ligjore gjithëpërfshirëse në lidhje me përfitimin e dhuratave

Disa lloje të zyrtarëve publikë janë të përjashtuar nga detyrimi për të deklaruar pasurinë dhe konfliktet e interesit

Mungesa e kërkesave të cilësisë për deklaratat e dorëzuara të pasurisë (lejohet dorëzimi i fotokopjeve jo të lexueshme nga makineritë, dokumente ku nuk mund të bësh kërkim për një fjalë (search), ose të shkruara me dorë)

Deklaratat e pasurisë përfshijnë "vlerësim personal" të vlerës së pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme ose klasifikim/përshkrim të pasaktë të pasurive

Vetëm familja e ngushtë (bashkëshortët ose bashkëjetuesit) kontrollohen pa vlerësime të rrezikut individual për fshehjen e pasurisë në rrethe më të gjera të individëve dhe bizneseve të lidhura

Disa autoritete mbikëqyrëse nuk kanë një objektiv fiks vjetor për numrin ose pjesën e deklaratave që duhen audituar dhe një proces kontrolli i detajuar fillon vetëm në rast se ngrihen dyshime të arsyeshme.

Autoritetet përkatëse nuk i krahasojnë të dhënat e marra nga deklaratat e pasurisë me regjistrat e tjerë publikë (pronë, shoqëri, taksa, aksione dhe letra me vlerë, dogana, kadastër, etj.)

Autoritetet zakonisht nuk hetojnë për mënyrën se si dikush ka marrë dhe zotëron prona përpara se të merrte detyrën

Deklaratat e pasurisë hiqen nga regjistrat publikë menjëherë pas përfundimit të mandatit të nëpunësit publik, gjë që pengon hetimet e mëtejshme, duke përfshirë median dhe shoqërinë civile

Mungesa e bazave të të dhënave publike të deklaratave të pasurisë të lexueshme dhe të shkarkueshme nga algoritmet kompjuterike

**Burimi:** CSD.

<sup>157</sup> Pritet që në vitin 2023 të vendoset detyrimi për të mbajtur të publikuar deklaratat e pasurive të zyrtarëve për një periudhë dy vjeçare.

kryen kontrole në regjistra të tjerë për pasuritë që mungojnë në deklaratë. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit të Malit të Zi, ka aftësinë teknike për të krahasuar të dhënat që vijnë nga bazat e të dhënave shtërore përmes aksesit të drejtpërdrejtë online, duke përfshirë të dhënat e Ministrisë së Brendshme, Administratës Tatimore, Administratës së Pasurive të Paluajtshme, Komisionit të Letrave me Vlerë, Regjistrin Qendror të Kompanive, Bankës Qendrore e Malit të Zi si dhe bankat komerciale (me kusht që të ketë një dakordësim për heqjen e rregullave të sekretit bankar). Në Maqedoninë e Veriut, prezantimi i një zgjidhjeje softuerike për ndërlidhjen e regjistrave të shumë institucioneve publike ishte planifikuar në fund të vitit 2019, por ende nuk është raportuar se funksionon zyrtarisht deri në momentin që flasim, viti 2022<sup>158</sup>.

Rekomandohet dhe shihet me rëndësi të madhe krijimi i një procedure të unifikuar kontrolli në të gjitha institucionet publike, bazuar në një grup të paracaktuar treguesish që në bazë të tyre disa deklaratime të klasifikohen si “flamuj të kuq” (Red Flags). Raporti aktual ofron një shembull të një **listë gjithëpërfshirëse të treguesve të rrezikut për kontrollin e deklaratave të pasurisë**, që mund të ndihmojë autoritetet kombëtare të përqendrojnë shqyrtimin e tyre në një numër më të vogël personash dhe kompanish të lidhura, duke ndihmuar punën e institucioneve kombëtare kundër korrupsionit dhe njësisive të brendshme të integritetit.

Në legjislacion dhe në procedurat për kontrollin e deklaratave të pasurisë janë të pranishme disa boshllëqe të vjetra ligjore. Disa nga këto boshllëqe duket se janë të përsëritura në të gjithë rajonin gjatë shumë viteve.

## Kapaciteti i kufizuar i autoriteteve kontrolluese

**Mungesa e të dhënave të krahasueshme** pengon analizën midis të gjitha vendeve të EJK-9, problem te cilit i shtohet edhe ngarkesa e lartë e punës së institucioneve kontrolluese, pa përmendur treguesit e tjerë përkatës, të cilët shpjegojnë shkallën e ulët të zbulimit dhe të sanksionimit. Megjithatë, disa **përfundime bazë për rajonin** mund të nxirren, bazuar në të dhënat e disponueshme:

- Numri i përgjithshëm i punonjësve në institucionet e kontrollit varion nga 20 deri në 300 persona.

<sup>158</sup> Gjithashtu lexo: Mia, “На ДКСК ѝ е неопходен софтвер за полесно да се бори против корупцијата” [SCPC-ja ka nevojë për softuer për të lehtësuar luftën kundër korrupsionit], 31 јануари 2020.

- Zyrtarët përgjegjës direkt për kontrollin e deklaratave të pasurisë varrojnë ndërmjet 4 dhe 45.
- Numri i personave që kanë detyrim ligjor për të deklaruar pasurinë është më i madh në Rumani në krahasim me vendet e tjera dhe më i vogël në Maqedoninë e Veriut dhe Kroaci<sup>159</sup>.
- Mesatarisht, rreth 12% e personave me detyrim ligjor kanë dorëzuar deklaratat e pasurisë me vonesë ose nuk i kanë dorëzuar fare.
- Përqindja e personave që janë kontrolluar nga autoriteti përkatës, përmes një kontrolli dytësor/të detajuar, varion ndërmjet 8% dhe 20%, me përjashtim të Malit të Zi (0.32%), Rumanisë (0.44%)<sup>160</sup> dhe Kroacisë (1.19%).
- Nga një inspektor kontrollohen në detaje nga 6 deri në 30 persona.

## Vendosja e sanksioneve nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet e tjera

Autoritetet e vendeve të EJK-9, drejtpërdrejt përgjegjëse për mbledhjen e deklaratave të pasurisë, i paraqesin informacion lidhur me çdo parregullsi të identifikuar, agjencive përkatëse (p.sh. taksat dhe të ardhurat) dhe prokurorisë. Megjithatë, **madhësia dhe ashpërsia e sanksioneve**, veçanërisht ato të vendosura nga institucioni kontrollues, janë të ulëta në të gjitha vendet e EJK-9 dhe nuk i pengojnë personat e ekspozuar politikisht të shkelin rregullat. Gjoha për vonesën ose mosdorëzimin e deklaratave të pasurisë zakonisht varion nga 200 deri në 1000 Euro. Disa persona të ekspozuar politikisht preferojnë të paguajnë gjobën dhe ende nuk dorëzojnë një deklaratë. Një çështje tjetër shqetësuese është **qasja arbitrare për të përcaktuar se kush duhet të hetohet** dhe të ndëshkohet. Sanksionet më të forta vendosen nga gjykatat (p.sh. me burgim), dhe në disa raste – nga autoritetet tatimore, kur zbulojnë shkelje tatimore në procesin e kontrollit të deklarimit të pasurisë. Informacioni për sanksionet e vendosura publikohet në

<sup>159</sup> Në Kroaci, numri i personave të cilët janë të detyruar të dorëzojnë deklaratat u rrit me rreth 1,250 si rezultat i Ligjit të ri për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Numri i përgjithshëm i personave të cilët ishin të detyruar të dorëzonin deklaratat për pasurinë dhe interesin ishte 3,350 në vitin 2022.

<sup>160</sup> Rumania është një nga vendet që bise në sy, pasi vendi ka numrin më të madh të personave të cilët janë të detyruar të deklarojnë pasuritë e tyre.

## Boshllëqe te gjata që ndikojnë në sanksionimin e parregullsive në deklaratat e pasurisë

Gjobat relativisht të vogla në raste mos-dorezimi, nuk inkurajojnë dorëzimin e deklaratave të pasurisë

Në shumë raste, kallëzimet penale kundër zyrtarëve publikë hidhen poshtë ose zëvendësohen me dënime të thjeshta (administrative).

Mungesa e përshkallëzimit të sanksioneve / sanksione më të rrepta kur kemi të bëjmë me situata të përsëritura të deklarimit të parregullt.

Emrat e zyrtarëve të lartë publikë të sanksionuar nuk publikohen hapur

*Burimi: CSD.*

shumicën e vendeve, me përjashtim të Shqipërisë dhe Hungarisë<sup>161</sup>. Në BiH, informacioni për sanksionet e vendosura është deklaruar në raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por vetëm në formë numrash zyrtarësh të sanksionuar, pa bërë të ditur identitetin e tyre.

Njihen **katër metoda**, të cilat përdoren më shpesh në vendet e EJK-9, **për shmangijen e dënimit** ose të paktën reduktimin e ashpërsisë së tij. Këto metoda përfshijnë:

- Mosdeklarimi i pasurisë, ose deklarate e rreme e pasurisë, duke ulur vlerën reale të saj;
- Ndikimi mbi autoritetet publike nëpërmjet presionit politik për të hequr dorë nga hetimi/ndjekja penale dhe/ose për të zëvendësuar një dënim më të rëndë (p.sh. burgim) me një sanksion më të lehtë (p.sh. një gjobë);
- Ndryshime prapavepruese të teksteve të deklaratës së pasurisë, për të hequr parregullsitë;
- Ndryshimi i legjislacionit, në mënyrë që, disa lloje zyrtarësh publikë (ose të afërm të tyre) të lihen jashtë rrethit të zyrtarëve të detyruar të deklarojnë pasurinë, rrethin shoqëror apo marrëdhëniet familjare.

## Disponueshmëria e të dhënave

Asnjë nga vendet e EJK-9 nuk ofron një bazë të dhënash të hapura të lexueshme nga makineritë dhe të

shkarkueshme në masë, që përmban të gjitha deklaratat e pasurisë të disponueshme. Vendet e analizuar mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- Nuk ka bazë funksionale të dhënash. I vetmi shtet i cili nuk ka krijuar ende një bazë funksionale të dhënash është Shqipëria, pasi Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) nuk ofron ende akses në një bazë të dhënash publike. Ekziston vetëm një regjistër i [Kërkesave dhe Përgjigjeve të Inspektoratit të Lartë ku publikohen përgjigjet](#) ndaj kërkesave zyrtare.
- Fotokopje të shkruara me dorë. Në Hungari, deklaratat e pasurisë përfshihen në një bazë të dhënash të kërkueshme; megjithatë, dokumentet janë fotokopje të mbushura me dorë, dhe si rrjedhim – të palexueshme nga makineria. Në Rumani, shumë deklarata ishin dorëzuar në format të shkruar me dorë deri në vitin 2021, përpara se detyrimi për të dorëzuar PDF-të e lexueshme nga makineritë të hynte në fuqi në vitin 2022. Nga viti 2023 e në vazhdim, do të pranohen vetëm deklaratat me nënshkrime dixhitale, me përjashtim të kandidatëve gjatë zgjedhjeve.
- Formati XML (i disponueshëm vetëm rast pas rasti). Ky format përdoret nga shumica e vendeve – Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Megjithatë, pavarësisht se është i lexueshëm nga makina, informacioni nuk mund të shkarkohet në masë, si një bazë e plote të dhënash. Kështu, çdo analizë e të dhënave të mëdha do të kërkojë që informacioni të kërkohet ose të kopjohet

<sup>161</sup> Në Hungari ekziston detyrimi ligjor për publikimin e vendimeve sanksionuese, por nuk zbatohet në praktikë, pasi që nga viti 2015 asnjë person i ekspozuar politikisht nuk është sanksionuar.

drejtpërdrejt nga faqja e Internetit. Kroacia ofron një rast hibrid, pasi deklaratat janë të disponueshme në të dy formatet XML, JSON dhe PDF.


Ndër aspektet pozitive, duhet theksuar se Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) i Maqedonisë së Veriut planifikon që në vitin 2023 të prezantojë një formë të deklarimit elektronik të pasurive dhe interesave, e cila do të jetë e lexueshme nga makineritë. Gjithashtu, po në 2023, ILDKPKI në Shqipëri planifikon të përmirësojë sistemin në mënyrë që të krijohet mundësia për të pasur akses të plotë dhe të lirë në deklaratimet e zyrtarëve nga ana e publikut të gjerë<sup>162</sup>. Në Rumani, platforma e paraqitjes elektronike e-DAI u prezantua më 1 janar 2022<sup>163</sup>. Që nga kjo datë,

Agjencia Kombëtare e Integritetit nuk pranon më deklarata të pasurisë dhe të konfliktit të interesave në format letre<sup>164</sup>.

### Shembuj të praktikave të mira për kontrolle efikase të deklaratave të pasurisë

Ka disa praktika të mira në EJM-9, që mund të shërbejnë si frymëzim dhe shembull për pjesën tjetër të vendeve nga rajoni dhe më gjerë. Ndër to mund të përmendim: përdorimin e platformave elektronike të cilat mundësojnë paralajmërime automatike të integritetit në Rumani; mbledhjen e informacionit mbi pronarët e vërtetë të pronave, kontrollet e kryqëzuara në regjistra të shumtë, zgjerimi i fushë-veprimit dhe numrit të personave që kanë

#### Parakushtet për kontrolle efikase të deklaratave të pasurisë



Burimi: CSD.

<sup>162</sup> Informacioni i marrë nga R2G4P bazuar në kërkesat zyrtare për informacion dhe takimet e zhvilluara me institucionet përkatëse.

<sup>163</sup> Agjencia Naionale de Integritate (A.N.I.), [COMUNICAT – privind transmiterea electronică a declarațiilor de avere și de interese exclusiv prin sistemul e-DAI și termenul de depunere a declarațiilor anuale](#) [Rumania, Agjencia Kombëtare e Integritetit, Komunikatë: në lidhje me transmetimin elektronik të deklaratave të pasurisë dhe interesit ekskluzivisht përmes sistemit e-DAI dhe afatit për dorëzimin e deklaratave vjetore], 8 prill 2022.

<sup>164</sup> Juridice.RO: [Declarațiile de avere și de interese vor fi transmise ANI exclusiv prin sistemul electronic e-DAI. UPDATE: 340.000 deponenți înregistrați](#) [Deklaratat e pasurisë dhe interesave do t'i dërgohen ANI ekskluzivisht përmes sistemit elektronik e-DAI], 2022.

detyrimin për të deklaruar pasurinë, praktikat e rritjes së ndërgjegjësimit në Kroaci, zgjerimin e autoritetit dhe rolit të organeve të tjera publike në kontrollin e rrethanave të dyshimta, ngritjen e kallëzimeve penale si dhe vendosjen e procedurave për heqjen e imunitetit në Serbi.

Ndërsa boshllëqet proceduriale dhe ligjore ndryshojnë në vende të ndryshme, disa **parakushte kryesore për kontrollin efikas** të deklaratave të pasurisë janë të dallueshme.

## Parregullsitë e prokurimit publik midis kompanive të ekspozuara politikisht

Prokurimi publik është konsideruar gjithmonë një nga **rrugët kryesore që të çojnë drejt korrupsionit dhe mashtrimit** nga ana e zyrtarëve publikë. Më shqetësues është fakti që prokurimet publike kanë qenë të lidhura ngushtë me praktikën e kapjes së shtetit dhe medias në rajon, mënyrë kjo që ka minuar vazhdimisht tranzicionin demokratik dhe të ekonomisë së tregut, duke penguar zgjerimin drejt BE-së dhe duke penguar që ndihmat që vijnë nga ndërkombëtarët të arrijnë synimet e kërkuara<sup>165</sup>. Raporti aktual grupon sëbashku një bazë të zgjeruar të dhënash mbi prokurimet publike dhe personat e ekspozuar politikisht për të analizuar **ndikimin e lidhjeve politike mbi rrezikun e korrupsionit në prokurimet publike**. Në këtë studim analizohen prirjet rajonale të EJL-9 dhe paraqet shembuj nga Bullgaria, Kroacia, Hungaria, Rumania, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Metodologjia e zbatuar bazohet në “flamujt e kuq” individualë, të cilët mund të grumbullohen më tej dhe të përfshihen në një rezultat në formë të përmbledhur që paraqet shkallën e integritetit.

Të dhënat tregojnë se në shumicën e vendeve të rajonit pesha e që zënë fondet e kontratave të fituara nga firmat e lidhura politikisht është më e lartë se pesha që zë volumni (numri) i kontratave të lidhura prej tyre. Në të njëjtën kohë, vihet re një diferencë e dukshme midis peshës mesatare të vlerës që firmat e lidhura politikisht zënë brenda pjesës së tyre të tregut dhe pjesës që të njëjtat firma të lidhura zënë në të gjitha tregjet së bashku (nuk është llogaritur nga ndarjet CPV<sup>166</sup>): në

shumicën e rasteve, mesatarja brenda pjesës së tregut është më e lartë. Kjo në mënyrë indirekte dëshmon se **firmat e lidhura politikisht janë të përqëndruara në tregje të caktuara** dhe jo të shpërndara nëpër sektorë të ndryshëm.

Për sa i përket llojit të blerësit (autoritetit të prokurimit publik), prirja rajonale është e larmishme dhe jo e kuptueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, në shumicën e rasteve ka një diferencë të dukshme midis karakteristikave të blerësit (blerësi mund të jetë nga fusha të ndryshme ose mbulon seksione të ndryshme si p.sh. autoritetet kombëtare kundrejt atyre rajonale) të kontratave të kompanive të lidhura politikisht kundrejt kontratave të kompanive të tjera jo të lidhura. Për shembull, në Rumani vihet re një numër më i madh kontratash të lidhura ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe kompanive të lidhura politikisht (40% kundrejt 20% midis kompanive që nuk shfaqin shenja të lidhjeve politike). Në të njëjtën kohë, në Hungari kategoria mbizotëruese janë kontratat e lidhura ndërmjet autoritetit rajonal dhe kompanive të lidhura politikisht (40% kundrejt rreth 30% ndërmjet kompanive që nuk shfaqin shenja të lidhjeve politike).

Për sa i përket llojit të procedurës, në shumicën e vendeve, pesha totale që zënë procedurat e hapura të konkurimit midis firmave të lidhura politikisht, ose është e pandjeshme ose është e kundërt me pritshmëritë (d.m.th., procedurat e prokurimit janë përgjithësisht më të hapura tek firmat e lidhura). Përqindja relativisht e lartë e procedurave të hapura midis firmave të lidhura politikisht mund të nënkuptojë se **në shumicën e rasteve, praktika të tjera përdoren për korrupsion** (p.sh. specifikimet e përshtatura të tenderit, periudha e shkurtër e shpalljes, etj.). Ky zbulim sugjeron se, me kalimin e kohës, ka të ngjarë që mjediset sistematike të korruptuara kanë prirje të **evoluojnë në praktikën e kapjes së shtetit**, sisteme në të cilat rregullat formale janë më shumë një test i thjeshtë për t'u kaluar. Ndryshime të tilla kërkojnë zhvillimin e sistemeve të reja dinamike për identifikimin e rrezikut, sisteme të cilat duhet të marrin parasysh dinamikën e reja të fushës së korrupsionit.

Mesatarja e indikatorit të integritetit (Integrity score) në rajon në të gjitha rastet është pak më e ulët për firmat e lidhura politikisht por me disa ndryshime midis vendeve. Në varësi të cilësisë së të dhënave, për disa vende

<sup>165</sup> Shentov, O., Stefanov, R., and Todorov, B. (eds.), *Geopolitics, State Capture and Peak Corruption. What is Next for Anticorruption in the Western Balkans?*, SELDI, 2022.

<sup>166</sup> Common Procurement Vocabulary (CPV).



modelet e rënies treguan rezultate më të forta dhe të pritshme se për të tjerat, **ku shumica e furnizuesve të lidhur politikisht rezultojnë më nivel integriteti më të ulët.**

### Rreziqet e korrupsionit pas COVID në prokurimet publike

Në shumicën e rasteve, pjesa e tregut që nuk ka të bëjë me shëndetësinë, nuk shoqërohet me ndonjë ndryshim domethënës si shkak i vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme, apo ndryshimit të legjislacionit që lejon përdorimin e procedurave me negociim të drejt-përdrejtë për blerjen e produkteve të lidhura me pandeminë COVID-19. Në të njëjtën kohë, dallohet se, niveli i integritetit ose ulet specifikisht vetëm për tregun e COVID-19 (Rumani, Hungari, Kroaci), ose rezulton me prirje rënëse për të gjithë tregun e kujdesit shëndetësor dhe me luhajtje të shpejta në tregun e COVID-19 (Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut), e cila shkon në të njëjtën linjë me prirjen Europiane.

### Rruga për të ecur përpara

Zhvillimi i mëtejshëm i metodologjive të vlerësimit të rrezikut, politikave procedurale dhe masave që synojnë parandalimin e korrupsionit, kapjes së shtetit<sup>167</sup>, pasurimin e paligjshëm dhe financimin e paligjshëm<sup>168</sup>, mund të arrihet vetëm përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve publike, shoqërisë civile, medias, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë. Përdorimi i një baze të zgjeruar të dhënash në veçanti, mund të lehtësojë identifikimin dhe sanksionimin e shkeljeve që janë të pranishme kur flasim për prokurimet publike, ndihmën shtetërore, koncesionet, investimet strategjike dhe fondet e BE-së. Përpjekjet për të siguruar nivele më të mira të qeverisjes në këtë fushë në EJK-9 janë bërë veçanërisht të nevojshme si

pasojë e rritjes së **rreziqeve të shkeljeve të sigurisë ekonomike** për shkak të pushtimit të Ukrainës nga Rusia si dhe **imponimin/ zbatimin e sanksioneve përkatëse**. Në këtë drejtim, vendet e rajonit tashmë kanë ndërmarrë nisma ligjore, politike dhe masa të ndryshme. Megjithatë, këto vende duhet të përmirësojnë vazhdimisht mbrojtjen dhe **të forcojnë zbatimin** në mënyrë që të garantohet siguria se këto vende nuk do të kthehen në hallkat më të dobëta të tregut të përbashkët BE/EEA.

**Rekomandimet kryesore të politikave** të shprehura më poshte mund të përdoren për të krijuar një bazament të fortë në mënyrë që të hidhen hapa të menjëhershëm, të cilët mund të ndihmojnë në zvogëlimin e hapësirave ekzistuese të qeverisjes dhe të neutralizojnë praktikën e kapjes së shtetit në EJK-9:

- **Procedura koherente e kontrollit të deklaratave të pasurisë.**
  - Autoritetet përkatëse duhet të kontrollojnë nëse deklaratat e pasurisë janë dorëzuar në kohë.
  - Autoritetet kundër korrupsionit duhet të krijojnë **një njësi të dedikuar apo departament** të fokusuar plotësisht në kryerjen e kontrolleve të detajuara (“auditime të stilit të jetesës”) të deklaratave të pasurisë. Këto njësi duhet të verifikojnë jo vetëm informacionin e raportuar, por nëse ka pasuri të fshehura ose të padeklaruara, ku të përfshihen pasuria e mundshme jashtë vendit dhe/ose të mbajtura nga miqtë dhe anëtarët e largët të familjes. Në mënyrë ideale, procedura duhet të përcaktojë origjinën e aseteve.
  - Ky organ duhet të përdorë një procedurë vlerësimi dhe kontrolli të rrezikut, bazuar në një **bazë të zgjeruar të dhënash dhe një grup “flamujsh të kuq”** në mënyrë që rastet të identifikohen automatikisht. Në vendet ku, më tepër se një agjenci është përgjegjës për kryerjen e kontrolleve, procedura duhet të unifikohet për të gjitha institucionet e qeverisë.
  - Ky organ duhet të kryejë tre lloje kontrollesh: një kampion i rastësishëm që i nënshtrohet kontrollit/auditimit të detajuar, kontrolle të grupeve prioritare/rrezikut, si dhe duhet të kontrollojë raste të dyshimta të ardhura prej indicjeve anonime të sjella nga palë të treta. Kjo do të rriste shkallën e zbulimit të parregullsive dhe do të zvogëlonte ndjenjën e pandëshkueshmërisë.

<sup>167</sup> Stoyanov, A., Gerganov, A., and Yalamov, T., *State Capture Assessment Diagnostics*, Sofia: Center for the Study of Democracy, 2019; Galev, T., Gerganov, A., and Todorov, B., *State Capture Deconstructed. Risk Measurement in Vulnerable Economic Sectors in Europe*, Sofia: Center for the Study of Democracy, 2021.

<sup>168</sup> R2G4P, *Second specialised regional training for R2G4P members: Innovative tools and methodologies for tracking illicit financial flows, state capture and corruption*, 18-20 May 2022, Budapest; *Presentation by Dr. Vanya Petrova*, Senior Analyst, Economic Program, Center for the Study of Democracy, 18-20 May 2022, Budapest.

- o Duhet të vendoset një bashkëpunim i fortë ndërmjet të gjitha organeve përkatëse (organet e anti-korrupsionit, taksave, financës, pastrimit të parave, prokuroria, etj.). Të dhënat e deklaruara në deklaratat e pasurisë **duhet të kryqëzohen me të dhënat nga regjistrat e tjerë** publikë (kombëtarë dhe ndërkombëtarë) sipas rregullave kombëtare dhe të BE-së për privatësinë e të dhënave, dhe, nëse është e nevojshme – me burime private (agjencitë profesionale, mediat sociale, etj.).
- o Organet e shumta ose palët e interesuara duhet të kenë mundësinë që ta paraqesin çështjen në prokurori ose autoritete të tjera gjyqësore përkatëse dhe të iniciojnë procedura administrative, penale (dhe nëse është e rëndësishme për opinionin publik). Hetimet nuk duhet të përjashtojë edhe çështjen për mënyrën se si dikush ka arritur të zotërojë prona përpara se të marrë detyrën.
- **Përmirësimi i bazës ligjore për sa i përket zbulimit të pasurisë.** Baza ligjore duhet të detyrojë policinë, doganat, menaxherët e lartë, drejtorët dhe anëtarët e bordit të ndërmarrjeve shtetërore, personelin ushtarak, anëtarët e partive politike (p.sh. ato jashtë parlamentit, por që marrin subvencione shtetërore), dhe aty ku është e nevojshme – anëtarët e grupeve më të rëndësishme fetare – të dorëzojnë deklaratat e pasurisë. Duhet të sqarohen në detaje specifikimet ligjore lidhur me kufizimet e periudhës pas lënies së detyrës për personat e ekspozuar politikisht, marrjen e dhuratave si dhe llojet e lejuara të të ardhurave shtesë për nëpunësit publikë. Baza ligjore mund të përmirësohet duke i detyruar personat e ekspozuar politikisht të zbulojnë jo vetëm shumicën e aksioneve që ata zotërojnë në një kompani, por gjithashtu edhe asetet e tjera që ata zotërojnë në atë biznes.
- **Transparenca dhe dixhitalizimi i deklaratave të pasurisë dhe regjistrave përkatës.** Vendet e Europës Juglindore (EJL-9) duhet të lejojnë që deklaratat e pasurisë të dorëzohen vetëm në formate elektronike, të lexueshme nga makineritë dhe algoritmet kompjuterike. Të gjitha deklaratat e pasurisë duhet të mbliidhen në një bazë të vetme të dhënash dhe/ose të aksesueshme përmes një faqeje Interneti të vetme të unifikuar. Organet përkatëse nuk duhet të lejohen të ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme deklarata-

tat e pasurisë, sidomos pas zbulimit të parregullive. Në rast ndryshimesh, si deklarata origjinale ashtu edhe ajo e korigjuar duhet të jenë të disponueshme për shqyrtim. Ekziston gjithashtu nevoja për krijimin e bazave të të dhënave të prokurimeve publike dhe të korporatave të cilat të jenë të lexueshme nga makineritë, si dhe bazat e të dhënave të personave juridikë dhe fizikë të sanksionuar, të cilat mund të shkarkohen në masë. Bazat e të dhënave duhet të përfshijnë informacion mbi pronësinë e kompanive përfutuese dhe të dhënat financiare në nivel kompanie. Rekomandohet gjithashtu që, të gjitha vendet të vendosin procedura për gjurmimin e transaksioneve me kriptovalutat dhe të harmonizojnë qasjet e tyre ndaj taksimit të aseteve në formën e monedhave virtuale (kriptomonedhat), siç sugjerohet nga Parlamenti Europian<sup>169</sup>.

- **Ndër-lidhja e regjistrave publikë.** Një parakusht thelbësor për përdorimin efikas të bazës së zgjeruar të të dhënave është që, të gjitha vendet e EJL-9 të ndërlidhin të gjithë regjistrat publikë. Ky është një proces me dy hapa – së pari, regjistrat kryesorë (bazë) duhet të lidhen me njëri-tjetrin: regjistri i personave fizikë (përfshirë gjendjen civile dhe anëtarët e familjes), regjistri i biznesit (personave juridikë) dhe regjistri i pasurisë. Së dyti, të gjithë regjistrat e mbetur duhet të bëhen bashkë në një regjistër të vetëm<sup>170</sup>.
- **Prezantimi i analizave të bazuara në të dhëna, lidhur me prokurimet publike dhe deklaratat e pasurisë.** Përdorimi i bazës së zgjeruar të të dhënave në funksion të analizës së riskut dhe evidentimit të rasteve në fazat fillestare, duhet të zhvillohet, përdoret dhe përditësohet rregullisht nga organet publike përkatëse, së bashku me shoqërinë civile, institucionet ndërkombëtare dhe mediat investigative.

Në lidhje me **deklaratat e pasurisë** – baza e zgjeruar e të dhënave duhet të përmbajë një grup indikatorësh që do të përdoren për të klasifikuar deklarata-

<sup>169</sup> European Parliament, *Cryptocurrency dangers and the benefits of EU legislation*, 11 October 2022.

<sup>170</sup> Tatimet, sigurimet shoqërore, hipoteka, regjistri i mjeteve motorike, regjistri i stoqeve dhe letrave me vlerë, regjistri i patentave dhe licencave, doganat, regjistrat e gjykatave, baza e të dhënave të financave të partive politike, etj.

tat me probleme si “flamuj të kuq” në mënyrë që të paralajmërohet nëse pasuria e paligjshme është fituar dhe/ose transferuar te të afërmit apo miqtë, dhe nëse ajo është fshehur në një zinxhir kompleks filialesh dhe kompanish fantazëm (duke përfshirë përdorimin e kompanive guackë dhe të personave jorealë). Për sa i përket sjelljes së kompanisë – baza e zgjeruar e të dhënave mund të zbulojë nëse kompanitë që kanë lidhje me persona të ekspozuar politikisht kanë volum qarkullimi të parave, pozicion në treg (monopolizim i mundshëm), fitim për punonjësit, etj., më të lartë – krahasuar me kompanitë pa lidhje politike në të njëjtin sektor. Në lidhje me **integritetin e prokurimit publik**, “flamujt e kuq” mund të paralajmërojnë kundër rasteve kur përfiton shumë herë një ofertues i vetëm, varësisë së blerësit nga furnizuesi, periudhës shumë të shkurtër të dorëzimit ose periudhës së marrjes së vendimit, rregjistrimi në parajsat fiskale, mungesës së shpalljes së thirrjes për tender, përdorimit të procedurave kufizuese, etj.

Bazuar në të dhënat e marra prej regjistrave publikë, qeverite e vendeve të EJK-9, të mbështetura nga shoqëria civile, rekomandohet të përpunojnë platforma elektronike me panele interaktive për zbulimin e rreziqeve të korrupsionit dhe modeleve të abuzimeve. Platforma të tilla mund të përfitojnë nga indikatorët (indikatorët e vendosur për klasifikimin si “Red Flag”) e testuar në kuadrin e nismës R2G4P, dhe të paraqitura në raportet aktuale dhe ato të ardhshme. Hapi tjetër dhe i fundit do të ishte zbatimi i Traktatit Ndërkombëtar për Shkëmbimin e të Dhënave për Verifikimin e Deklaratave të Pasurive<sup>171</sup>.

- **Përmirësimi i konkurrencës në prokurimet publike dhe reduktimi i përdorimit të procedurave jokonkurrese.** Paralelisht me përdorimin e flamujve të kuq, baza ligjore e prokurimeve publike duhet gjithashtu të rikthehet plotësisht në gjendjen e saj para COVID-19, duke hequr të gjitha procedurat “e përkohshme” të urgjencës (me fokus të veçantë në uljen e pjesës që zënë kontratat me një ofertues të vetëm). Kriteret objektive të vlerësimit të ofertave dhe përputhja e madhësive të tenderëve me kapacitetin e tregut kanë gjasa të rrisin në mënyrë potenciale nivelin e konkurrencës në prokurimin publik. Rritja e numrit të njerëzve që punojnë drejtpërdrejt me dokumentet e prokurimit, mund të përmirësojë shpejtësinë e përgjithshme të periudhës së vendimmarrjes, si dhe cilësinë e vlerësimit dhe vendimeve.
- **Dënim efikas.** Një nga çështjet më shqetësuese, e theksuar shpesh nga shoqëria civile, në nivelin e organeve ndërkombëtare dhe ato të BE-së, është se, shumica e akuzave penale kundër zyrtarëve publikë hidhen poshtë ose zëvendësohen me sanksione më të lehta (administrative), veçanërisht kur bëhet fjalë për persona që vijnë nga rangjet më të larta politike. Në të njëjtën kohë, gjobat relativisht të vogla nuk inkurajojnë respektimin e plotë të ligjit. Kështu, është e rëndësishme që politikë-bërësit të sigurohen që masa dhe ashpërsia e dënimeve të jenë mjaft të larta (largim nga puna, sekuestrim i pasurive, burgim), ndjekja penale të jetë më e efikase dhe vendimet përfundimtare të dënimeve të publikohen në Internet. Vendet e EJK-9 duhet të krijojnë më tej një mekanizëm për heqjen e imunitetit, veçanërisht për rastet e procedimeve penale.

<sup>171</sup> Regional Anti-Corruption Initiative, [Regional Data Exchange on Asset Declarations and Conflict of Interest](#), RAI, 2021.